



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PEJË

---

AD/GJTHPE/.nr.07/25

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit D.N, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga avokat H.Sh, nga P..., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 12.03.2025 mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e parashtruar nga avokati H.Sh nga P..., ndaj gjyqtarit D.N, **SI E PABAZUAR.**

### A r s y e t i m

Me datë 14.02.2025, avokati H.Sh, nga P..., ka parashtruar ankesën disiplinore ndaj gjyqtarit D.N, për shkak se me datën 12.02.2025, gjyqtari kishte caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për lëndën e paditëses F.L SH.P.K, me seli në P..., të cilën e përfaqëson si i autorizuar i paditëses. Në fillim të seancës, gjyqtari konstatoi pjesëmarrjen e tij dhe verifikon praninë e av.M.K, i cili ishte ftuar në mënyrë të rregullt, por nuk kishte arsyetuar mungesën e tij, e që gjyqtari konstatoi se av.M.K nuk kishte dorëzuar autorizimin për të përfaqësuar të paditurin B.G, për këtë arsye arriti në përfundim se nuk kishte kushte për mbajtjen e shqyrtimit kryesor. Në këtë moment, parashtruesi ka kërkuar fjalën për të sqaruar se në seancën e dates 26.12.2024, gjykata tashmë kishte marr vendim duke konstatuar se av.M.K nuk kishte autorizim për të përfaqësuar të paditurin, për këtë arsye, ka theksuar se dështimi i mbajtjes së kësaj seance, për të njëjtën arsye si në seancën e mëparshme, përbënte një gabim procedural nga ana e gjykatës. I njëjti ka konstatuar se gjykata nuk kishte ftuar të paditurin B.G, përkundër faktit se në procesverbalin e dates 26.12.2024, është marr vendim nga gjyqtari që ai të ftohej, pasi edhe gjyqtari kishte konstatuar se av.M.K nuk kishte autorizim për këtë lëndë. Po ashtu ka shtuar se edhe seanca e kaluar ishte shtyrë për shkak të një shkelje të gjykatës, pasi e njëjta kishte caktuar shqyrtimin kryesor me 26.12.2024, edhe pse kishte detyrim që në afatin e rregullt t'u dorëzonte palëve aktvendimin e Gjykatës Supreme. Përkundër këtij obligimi, gjyqtari caktoi seancën pa u siguruar që palët kishin marrë aktvendimin Rev.nr.391/2023, të dates 25.01.2024, të njëjtat ka kërkuar që në procesverbal të evidentohen se dy dështimet e mos mbajtjes së shqyrtimit kryesor janë rezultat i shkeljeve procedural të gjykatës, i njëjti është shprehur se citoj “*gjyqtari i revoltuar reagoi me ton të lartë, në drejtim të tim dhe të zyrtarës ligjore A.G se nuk ka kushte për mbajtjen e seancës*”. Pavarësisht insitimit të tij që deklarat e tij të përfshihet në procesverbal, sipas pretendimeve të parashtruesit gjyqtari ka refuzuar të konstatojë dhe ka vendosur

që nuk kishte kushte për vijimin e shqyrtimit kryesor. Si rezultat i mos konstatimit të fjalëve të parashtruesit në procesverbal, i njëjti shprehet se është ngritur në këmbë dhe ka deklaruar citoj “*se do të lëshoja seancën dhe nuk do ta nënshkruaj procesverbalin*”. Tutje, ka theksuar se ka dëgjuar gjyqtarin duke diktuar tek zyrtarja ligjore me fjalët “*I autorizuari i paditësit Av.H.Sh, refuzon nënshkrimin e procesverbalit pa ndonjë justifikim*”, në atë çast i njëjti iu është drejtuar gjyqtarit “*a nuk e arsyetova refuzimin e nënshkrimit aa?*” Andaj tutje ka theksuar që nga marrja e lëndës nga gjyqtari i njëjti ka bërë shkeljet e njëpasnjëshme në këtë çështje juridiko-civile, që nga data 25.01.2024 kur është marrë vendimi nga Gjykata Supreme nuk ka informacion të saktë mbi datën kur ky vendim është pranuar nga Gjykata Themelore në Pejë apo kur i është dorëzuar gjyqtarit përkatës, e bazuar në praktikën gjyqësore dorëzimi kryehet brenda 30 ditëve, e duke llogaritur muajin mars e deri me dt.26.12.2024 kur është caktuar seanca e shqyrtimi kryesor kanë kaluar afro 300 ditë. E sipas nenit 199 të LPK-së, pas arritjes së aktvendimit nga shkalla e dytë, seanca e shqyrtimit kryesor duhet të caktohet brenda një afati maksimal prej 30 ditësh, dhe shtyrja e një afati ligjor prej 30 ditësh në 300 ditë përbën një shkelje të rëndë dhe të patolerushme. Gjatë këtij procesi, kreu një shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi caktoj shqyrtimin kryesor pa e ekspeduar aktvendimin e Gjykatës Supreme, e që gjatë seancës, ka deklaruar se pavarësisht vonesës tashmë që aktvendimi më është dorëzuar mund të procedojë në shqyrtimin kryesor, e gjyqtari konstatoi se nuk kishte kushte për mbajtjen e seancës, me arsyetimin se mungonte autorizimi i av.M.K për përfaqësimin e të paditurit, e në atë seancë u mor vendimi që në vijim të ftohet drejtpërdrejtë i padituri B.G. Pastaj me caktimin se seancës së dates 12.02.2025, duke e shtyrë shqyrtimin kryesor edhe për 48 ditë të tjera, ky veprim është një prolongim i pajustificueshëm i procedurës. Sa i përket kësaj çështje së autorizimit, gjyqtari vazhdon të këmbëngulë se ai nuk ka autorizim për përfaqësimin e të paditurit, por nuk e fton të paditurin B.G për seancën e shqyrtimit kryesor, tutje ka theksuar se av.M.K ka ushtruar revizion pranë Gjykatës Supreme dhe ky revizion është nënshkruar me vulë nga vetë av.Mustafë, në cilësinë e përfaqësuesit të të paditurit, e ky insistim i gjykatës që ska autorizim, pavarësisht faktit se ai ka përfaqësuar të paditurit në një revizion të dorëzuar dhe pranuar nga Gjykata Supreme, është një veprim i dyshimtë dhe i pakuptimtë në aspektin procedural. Tutje është shprehur se në seancën e shqyrtimit kryesor të dates 12.02.2025, gjyqtari ka dorëzuar një shkresë të ushtruar nga av.M.K, dt.24.12.2024, ky dorëzim nuk u konstatuar në procesverbal edhe pse gjyqtari duhej ta kishte dorëzuar këtë shkresë që në seancën e shqyrtimit kryesor të dates 26.12.2024, e që nga përmbajtja e kësaj shkrese i njëjti kishte kërkuar shtyrjen e shqyrtimit kryesor dhe nëse gjykata nuk miraton shtyrjen të veprohet konform vërejtjeve dhe sugjerimeve të aktvendimit të Gjykatës Supreme, andaj kjo situatë ka ngre dyshime duke e prolonguar procedurën në mënyrë të pajustificueshëm, dhe ka ngritur pikepyetje se cili është qëllimi i gjyqtarit dhe pse po zvarritet qëllimisht shqyrtimi i çështjes dhe pse gjykata nuk e shqyrtoj kërkesën për shtyrjen e seancës me datën 24.12.2024. Pra, duke u mbështetur në nenin 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve, në pikat 1.3,2.2, dhe 2.7, ka vlerësuar se gjyqtari ka kryer shkelje të rënda të detyrës zyrtare duke cenuar integritetin e procesit gjyqësor dhe duke ngritur dyshim të arsyeshme mbi paanësinë e tij në këtë çështje. Pra ka përmbledhur pretendimet duke theksuar se gjyqtari ka kryer shkeljet e detyrës zyrtare nga neni 5, pika 1.3, ka zvarritur në mënyrë të pajustificueshëm procedurën, duke caktuar shqyrtimin kryesor pas 300

ditësh, përkundër afatit ligjor prej 30 ditësh, sipas nenit 199 të LPK-së, shtyrja e seancës për 48 ditë, nga dt.26.12.2024 në 12.02.2025 duke prolonguar procedurën pa arsye të ligjshme, mosrespektimin e detyrimit për të ekspeduar aktvendimin e Gjykatës Supreme, refuzimi për të konstatuar deklaratat dhe pretendimet e palëve në procesverbal. Ndërsa sipas dispozitës neni 5, pika 2.2 trajtimi jo i drejtë i palëve dhe pjesëmarrësve në proces, gjyqtari ka shkelur këtë detyrim për shkak të: mosnjohjes së statusit të përfaqësuesit të pales së paditur ndonëse ai ka ushtruar revizion pranë Gjykatës Supreme, mospërfshirja e fakteve relevante në procesverbal si dhe mohimit të së drejtë për të dokumentuar shkeljet procedurale në procesverbal, dhe nga dispozitat e nenit 5 pika 2.7 mos kryerja e detyrave zyrtare në afatet e përcaktuar me ligj siç dëshmohet nga: shkelja e afatit prej 30 ditësh për caktimin e shqyrtimit kryesor, shtyrja e pajustificueshëm e seancave, ndryshimit të fjalëve në procesverbal duke pretenduar se nuk ka dhënë arsye për refuzimin e nënshkrimit të procesverbalit e që qartë e ka arsyetuar këtë vendim. Duke pasur parasysh këto shkelje, ka kërkuar që në procesverbal të evidentohen se dy dështimet e mbajtjes së shqyrtimit kryesor ishin rezultat i shkeljeve procedural të gjykatës, e që gjyqtari ka refuzuar t'i konstaton dhe vendosi që nuk kishte kushte për vijimin e shqyrtimit kryesor, e në shënjë proteste ka lëshuar seancën dhe nuk ka nënshkruar procesverbalin. Sipas neni 11 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve çdo shkelje që përmban elemente të veprës penale duhet t'i referohet prokurorit të shtetit, i cili më pas vendos për ndjekjen ose jo të çështjes penale, veprimet e gjyqtarit mund të përmbajnë elemente të veprës penale: keqpërdorim i detyrës zyrtare duke manipuluar procesverbalin dhe duke shtrembëruar të dhënat zyrtare, pengimi i ushtrimit të drejtësisë si dhe shpërdorim i pozitës zyrtare duke përdorur autoritetin e tij për të prolonguar procesin dhe për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në rrjedhën e çështjes. Andaj referuar të lartëcekurat ka propozuar që të shqiptohet njëra nga këto masa: zvogolim i përkohshëm i pages deri në 50% për një periudhë deri në një vit, e që do të kishte efekt ndëshkues duke reflektuar seriozitetin e shkeljeve të tij apo transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një division me të ulët, siç është divizioni për kundërvajtje, e që do të ishte një masë e justifikueshme megjithatë nuk do të eliminonte rrezikun që ai do të vazhdoj të keqpërdorë detyrën e tij edhe në një gjykatë tjetër.

Me datë 14.02.2025, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga avokat H.Sh, ndaj gjyqtarit D.N.

Gjyqtari D.N, me datën 24.02.2025 ka përcjell deklaratën me shkrim, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka deklaruar se e kundërshton në tërësi pretendimet e parashtruar në ankesën disiplinore. Me datën 02.10.2024 avokati ka parashtruar urgjencë për caktimin e seancës gjyqësore në lëndën C.nr.4193/24, ku ka deklaruar se Gjykata Supreme përmes aktvendimit Rev.nr.391/23, të dt.24.01.2024 ka anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore dhe rastin e kthyer në rigjykim, dhe ka kërkuar të caktohet seanca e shqyrtimit kryesorë pasi rasti është me prioritet. Kjo lëndë është pranuar nga zyrtarët përgjegjës të gjykatës me datën 29.10.2024, siç shihet avokati ka kërkuar caktimin e seancës edhe pse lënda nuk ka qenë fizikisht në Gjykatën Themelore në Pejë. Tutje ka theksuar se lëndën e ka

pranuar nga personat përgjegjës në zyrën e tij me datën 26.11.2024 dhe është evidentuar në librin e pranimit të lëndëve, pas pranimit të lëndës gjyqtari ka caktuar seancën me datën 26.12.2024, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh dhe nuk qëndron pretendimi se seanca nuk është caktuar mbi 300 ditë. Ndërsa për të gjitha veprimet procedurale që gjykata i ka ndërmarr sa i përket shtyrjes së seancave hyjnë në kuadër të veprimeve procedurale, për të cilat palët në procedurë kanë të drejtë të paraqesin mjete juridike në instancat më të larta dhe nuk mund të konsiderohen shkelje ligjore në kuptim të përgjegjësisë disiplinore. Ka deklaruar se me përgjegjësi të gjitha veprimet si gjyqtar i ka realizuar me integritet, ndershmëri dhe përgjegjësi, me qëllim që të gjitha palët në procedurë të njoftohen në mënyrë të rregullt për procesin kontestimor dhe nuk ekziston asnjë qëllim për prolongim të çështjes, duke marr parasysh se si gjyqtar ka ndërmarr veprimet në drejtim të caktimit të seancës kryesore pasi lënda përbënte prioritet. Tutje, ka theksuar se pretendimet për zvarritje të procedurës, mund të parashtrohen në instancat kushtetuese, sepse tani sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Strasburgut, secila palë mund të parashtrojë ankesë kushtetuese edhe pa përfunduar procesi kontestimor. Sa i përket pretendimit se seanca është caktuar jashtë afatit ligjor, gjykata sqaron se seanca e datës 12.02.2025 është caktuar konform agjendës dhe ngarkesës paraprake të cilën e ka pasur gjyqtari i çështjes, e që avokati nuk ka pasur vërejtje sipas procesverbalit të dt.26.12.2024, e të cilin edhe e ka nënshkruar. Sa i përket pretendimit për shtyrjen e seancave gjyqësore, konsideron se kanë ndodhur vetëm me qëllim që gjykata të respektoj neni 6 të KEDNJ-së, në mënyrë që gjitha palëve t'u ofroj qasje në drejtësi dhe vetëm me qëllim që të krijohen kushtet procedurale për mbajtjen e seancës. Tutje, ka sqaruar se me qëllim që seanca të mos dështonte, gjykata ka ftuar për seancën e dt.12.02.2025 avokatin S.B dhe avokatin M.K, siç është konstatuar në procesverbal të dt.12.02.2025 avokati S.B përmes parashtresës ka njoftuar gjykatën se e denoncon autorizimin ndaj të paditurit B.G, e në anën tjetër avokati M.K nuk kishte prezantuar në seancë. Në këtë drejtim, gjykata ka caktuar seancën e radhës me datën 06.03.2025 dhe pas shtyrjes së seancës së datës 12.02.2025 gjykata me qëllim të krijimit të kushteve procedurale ligjore, ka nxjerr aktvendim procedural përmes së cilit ka urdhëruar avokatin M.K që në afat prej 3 ditësh, të dorëzoj prokurën e noterizuar dhe të nënshkruar nga i padituri, dhe të gjitha këto veprime procedurale gjykata i ka bërë me qëllim që seanca të mbahet. Me datën 14.02.2025, avokati M.K ka dorëzuar autorizimin e noterizuar dhe ish-in plotësuar të gjitha kushtet ligjore për mbajtjen e seancës për datën 06.03.2025. Tutje ka theksuar se sa i përket parashtresës së datës 24.12.2024, që e ka dorëzuar avokati M.K, këtë paraashtresë gjykata nuk e ka pasur në shkresë të lëndës me datën e mbajtjes së seancës së dt.26.12.2024, dhe për këtë nuk ishte konstatuar në procesverbal pasi që parashtresa nuk kishte qenë në zyrën e gjyqtarit, e që me qëllim të njoftimit të palëve për këtë parashtresë e kishte njoftuar avokatin H.Sh me datën 12.02.2025 dhe arsyen se kjo parashtresë është pranuar me vonesë në zyrë. Sa i përket pretendimit se gjykata nuk i ka dorëzuar aktvendimin e Gjykatës Supreme, kjo rrethanë nuk ka qenë arsyeja për shtyrjen e seancës dhe këtë aktvendim gjykata i ka dorëzuar drejtpërsëdrejti avokatit në fjalë në seancën e datës 26.12.2024, edhe sikur palët të kishin nevojë për kohë shtesë, gjykata do t'i siguronte kohën e tillë, e që avokati nuk kishte kërkuar kohë shtesë. Ka deklaruar me përgjegjësi të lartë morale dhe profesionale se jo vetëm këtë lëndë, por në të gjitha lëndët nuk shmang asnjëherë nga zbatimi parimin e paanshmërisë, respektimit të dinjitetit të palëve në procedurë dhe

asnjëherë nuk ekziston qëllimi siç pretendohet në këtë ankesë. Për veprimet procedurale palët apo të autorizuarit mund të kenë pakënaqësi, por veprimet procedurale janë objekt shqyrtimit pranë instancave me të larta, e sikur të lejoheshin kërkesa të tilla për veprime procedurale do të cenohej rëndë pavarësia e gjyqtarit dhe rritja e presionit nga jashtë ndaj sistemit të drejtësisë në përgjithësi. Referuar Opinionit nr.27 (2024) i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (CCJE) mbi përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, përcaktohet se një ndër parimet kryesore për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit është mos fillimi i procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve për të drejtat ligjore-procedurale të ushtruara gjatë procedurës dhe ky përcaktim është digë e rëndësishëm me qëllim që gjykata të jetë e pavarur, po në të njëjtën kohë llogaridhënëse ndaj palëve dhe publikut. Andaj, ka konsideruar se ankesa disiplinore, ka tejkaluar kufijtë e rregullativës ligjore, pasi kjo ankesë përmban edhe elemente fyese për gjykatësin dhe tendencë për uljen e reputacionit të gjykatës në përgjithësi. Dhe në pjesën e ankesës ku ceket se transferimi në një devizion tjetër nuk do të eliminonte rrezikun që ai do të vazhdojë të keqpërdorë detyrën e tij edhe në një gjykatë tjetër, ky deklaram siç vërehet ka marr trajtë fyese pasi flet për situatë hipotetike për të cilat nuk ka ndodhur dhe vërehet qartazi se ankesa përmban edhe elemente fyese dhe denigruese ndaj gjyqtarit me qëllim të uljes së reputacionit të gjykatës në përgjithësi. Përfundimisht ka ritheksuar se secili veprim procedural është bërë me qëllim të realizimit të kushteve procedurale, me të vetmin qëllim që të gjitha palët në procedurë t'u jepet mundësia e dhënies së deklaramit dhe veprimet janë ndërmarr drejt caktimit të seancave gjyqësore, dhe kompetencat si gjyqtar i ushtron me integritet, profesionalizëm, ndershmëri, dhe pa paragjykime, duke konfirmuar parimin se të gjitha palët dhe të autorizuarit janë të barabartë para ligjit.

Me qëllim të vlerësimit të veprimeve të gjyqtarit D.N autoriteti kompetent i është drejtuar zyrtares ligjore pranë zyrës së gjyqtarit A.K, me kërkesë për dhënie të deklaramit për rastin e ndodhur, fjalët dhe veprimet e avokatit në këtë seance dhe të gjyqtarit. Ka kërkuar nga njëjta të deklaramit se a qëndrojnë këto pretendime të avokatit në fjalë, a janë konstatuar thëniet e avokatit në procesverbal apo a i është mohuar konstatimet në procesverbal, si dhe për çdo detaj tjetër lidhur me këtë lëndë, pasi që në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.02.2025 ka qenë prezentë në cilësinë e procesmbajtëses.

Zyrtarja Ligjore A.K, në deklaramitën e dhënë me shkrim e njëjta ka përshkruar se në seancën e datës 12.02.2025, në ora 13:00, ka filluar konstatimet për seancë, i cili nuk ishte prezent av.M.K, gjyqtari e ka konstatuar se nuk posedon autorizim për përfaqësim dhe ishte duke diktuar se nuk ka kushte procedurale dhe e njëjta ishte duke shënuar se nuk ka kushte për mbajtjen e seancës, dhe duke i bërë konstatimet gjyqtari, avokati H.Sh u ngrit në këmbë citoj “*do ta lëshojë seancën dhe nuk e nënshkruaj procesverbalin*”, dhe gjyqtari deklaroi se nuk ka kushte pa pas palën tjetër prezent, pastaj pa ndonjë justifikim dhe pa lejen e gjykatës ai duke dal tha citoj “*a nuk e arsyetova refuzimin e nënshkrimit a*”. Pastaj gjyqtari ka filluar të diktojë se nuk ka kushte për mbajtjen e seancës, andaj nuk ja ka dhënë fjalën për këtë arsye dhe të tjerat i kemi konstatuar në procesverbalin e dt.12.02.2025. Sjellja e gjyqtarit ka qenë korrekte me palën tjetër.

Kryetari i Gjykatës, duke vepruar brenda kompetencave dhe autorizimeve si autoritet kompetent, me qëllim të vlerësimit për shkelje të mundshme disiplinore nga ana e gjyqtarit, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar ankesën disiplinore të parashtruesit, deklaratën e gjyqtarit dhe deklaratën e zyrtares ligjore pranë zyrës së gjyqtarit, dhe pas shqyrtimit të dosjes së lëndës C.nr.4193/24, ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar.

Pretendimi i parashtruesit se nuk janë konstatuar në procesverbal se dy dështimet e mos mbajtjes së shqyrtimit kryesor janë si rezultat i shkeljeve procedurale të gjykatës dhe pretendimet tjera në drejtim të konstatimeve në procesverbal, këto pretendime nuk janë mbështetë me asnjë provë nga ana e parashtruesit, e duke marr parasysh faktin se në seancën gjyqësor të datës 12.02.2025 kanë qenë prezentë gjyqtari i çështjes, procesmbajtësja, dhe parashtruesi në cilësinë e të autorizuarit të palës paditëse, dhe në vlerësim të vetmes provë për këtë pretendim që është deklarata e zyrtares ligjore, e cila ka mohuar të ketë parë ndonjë sjellje të njëanshme të gjyqtarit e që ka deklaruar se gjyqtari ka pasur sjellje korrekte e në përshkrim të rastit nga e njëjta dhe deklarimeve të saj për seancën e datës 12.02.2025, autoriteti kompetent me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të vërtetojë faktin se gjyqtarit ka ndryshuar fjalët në procesverbal apo ka refuzuar që të përfshirën faktet relevante në procesverbal pasi në atë seancën sipas gjyqtarit të çështjes nuk ka pas kushte që të mbahet seanca. Pretendimet e ankuesit në drejtim të mos konstatimeve në procesverbal nuk kanë arritur që provohen me asnjë provë të vetme, andaj për Kryetarin e Gjykatës si Autoritet Kompetent, mbeten të paprovuar pretendimet e tilla, e duke qenë të paprovuara këto pretendime mbetën vetëm supozime të palës ankuese.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit se seanca është caktuar jashtë afatit ligjor me një vonesë prej 300 ditësh, ky pretendim u kundërshtuar nga gjyqtari i çështjes, i cili sa i përket këtij pretendimi ka theksuar se lëndën e ka pranuar nga personat përgjegjës në zyrën e tij me datën 26.11.2024 dhe është evidentuar në librin e pranimit të lëndëve, pas pranimit të lëndës gjyqtari ka caktuar seancën me datën 26.12.2024, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh dhe nuk qëndron pretendimi se seanca nuk është caktuar mbi 300 ditë, kjo gjë është vërtetuar edhe përmes librit të pranimit të lëndëve nga ana e gjyqtarit, e që figuron se kjo lëndë është pranuar në zyrën e gjyqtarit me datën 26.11.2024.

Në ankesën disiplinore parashtruesi është thirrur se që nga data 25.01.2024 kur është marrë vendimi nga Gjykata Supreme nuk ka informacion të saktë mbi datën kur ky vendim është pranuar nga Gjykata Themelore në Pejë apo kur i është dorëzuar gjyqtarit përkatës, andaj lidhur me këtë ju sqarojmë se kjo lëndë fizikisht në Gjykatën Themelore në Pejë është pranuar me datën 29.10.2024, vërtetuar kjo përmes vulës së pranimit të gjykatës, e cila evidentohet nën numrin 10756/24, nënshkruar nga zyrtarja për pranim, ndërsa sipas regjistrave të gjyqtarit për pranimin e lëndëve kjo lëndë është pranuar në zyrën e gjyqtarit me datën 26.11.2024, dhe gjyqtari ka caktuar seancën me datën 26.12.2024. Vonesa në përcjelljen e lëndës nga personat përgjegjës tek zyra e gjyqtarit ka rrjedh vetëm për faktin e mbingarkesës dhe volumit të madh të lëndëve të pranuar dhe nuk ka qenë ndonjë veprim i qëllimshëm për prolongim të kësaj lëndë, për këtë parregullsi nga

shkrimorja civile është njoftuar U.D Administratori i gjykatës për të ndërmarr veprimet e nevojshme në drejtim të kësaj vonesë.

Ndërsa për pretendimin për mos ekspedimin me kohë të aktvendimit të Gjykatës Supreme, është fakt se vendimi nuk është ekspeduar me kohë palëve apo të autorizuarit të tyre dhe ky fakt është konstatuar edhe në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 26.12.2024, fq.1, ku pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjyqtari ka vërejtur se aktvendimi nuk i është ekspeduar me kohë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse dhe këtë aktvendim gjykata i ka dorëzuar drejtpërsëdrejti avokatit në fjalë në seancën e datës 26.12.2024, e që i njëjti pavarësisht se ka pranuar në seancë aktvendimin ka qenë i gatshëm të lëshohet në shqyrtim gjyqësore, të cilin procesverbal i njëjti kishte nënshkruar dhe nuk është konstatuar ndonjë vërejtje në këtë drejtim.

Parashtruesi në ankesën disiplinore kishte theksuar faktin se shkresa e datës 24.12.2024, i është dorëzuar parashtruesit në seancën e datës 12.02.2025, dhe kjo situatë ka ngre dyshime duke e prolonguar procedurën në mënyrë të pajustificueshëm, dhe ka ngritur pikepyetje se cili është qëllimi i gjyqtarit dhe pse po zvarritet qëllimisht shqyrtimi i çështjes dhe pse gjykata nuk e shqyrtoj kërkesën për shtyrjen e seancës me datën 24.12.2024, lidhur me këto çështje të ngritura gjyqtari i çështje ka sqaruar se parashtruesin e datës 24.12.2024, që e ka dorëzuar avokati M.K gjykata nuk e ka pasur në shkresa të lëndës me datën e mbajtjes së seancës së datës 26.12.2024 dhe për këtë nuk ishte konstatuar në procesverbal pasi që parashtruesi nuk kishte qenë në zyrën e gjyqtarit, e që me qëllim të njoftimit të palëve për këtë parashtruesë e kishte njoftuar avokatin H.Sh me datën 12.02.2025, dhe lidhur me këtë parashtruesë është konstatuar edhe në procesverbalin e seancës së datës 12.02.2025, fq.1.

Parashtruesi në ankesën disiplinore ka kërkuar që të veprohet konform nenit 11 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve duke pretenduar se veprimet e gjyqtarit mund të përmbajnë elemente të veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare si dhe shpërdorim i pozitës zyrtare, Kryetari i Gjykatës me vemendje ka analizuar këto pretendime dhe ka gjetur se pretendimet e parashtruesit për shkeljet e supozuara disiplinore janë të pabazuara andaj rrjedhimisht nuk mund të veprohet konform neni 11, par.1 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pasi që në rastin konkret autoriteti kompetent ka konstatuar se nuk ekziston as ndonjë shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit të çështjes.

Lidhur me pretendimet që kanë të bëjnë se pse gjyqtari kishte insistuar që avokati M.K nuk kishte autorizim për përfaqësimin e të paditurit, e nga i njëjti kishte kërkuar autorizimin e noterizuar, lidhur me të njëjtat Kryetari i Gjykatës gjen se veprimet e gjyqtarit të çështjes janë veprime procedurale të cilat i ndërmerr duke vepruar brenda autorizimeve dhe kompetencave të tij ligjore në drejtim të zgjidhjes së çështjes, të cilat veprime procedurale janë në diskrecion të gjyqtarit të çështjes, andaj nga pretendimet e tilla nuk mund të nxjerrën rrethanat që mund të vejnë në dyshim objektivitetin dhe paanësinë e gjyqtari e që i njëjti ka vepruar me qëllim të prolongimit të procedurës.

Autoriteti kompetent vlerëson se në esencë në ankesë disiplinore janë shprehur pakënaqësitë e avokatit ndaj veprimeve të marra nga gjyqtari me qëllim të drejtimit të procedurës dhe plotësimit të kushteve për mbajtjen e seancës gjyqësore, veprime këto të cilat nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore, pasi veprimet e tilla procedurale të gjyqtarit janë subjekt i vlerësimit të gjykatave të shkallëve më të larta, si gjykata kompetente për vlerësimin e saktësisë dhe ligjshmërisë së vendimeve të gjyqtarëve.

Andaj, mbi këto baza dhe argumente vërtetohet se në veprimet e gjyqtarit nuk janë konstatuar shkelje të ligjit, të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore, për këtë arsye Kryetari i Gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi nga të lartcekurat nuk rezulton se veprimet e ndërmarra nga gjyqtari përbëjnë bazë për inicimin e procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.07/25, me datë 12.03.2025**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit D.N*
- 3. Parashtruesit të kërkesës avokatit H.Sh*